



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:141241
Datë: 02.05.2024
Numri i dokumentit: 05645460

C.nr.2231/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, Gjyqtarja Dora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.B. nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. B.Gj. nga Prizreni, kundër të paditurës H.S. me vendbanim në rr. “.....” të cilën e përfaqëson av. E.Gj. nga Prizreni, me objekt kontesti vërtetim i pronësisë, jashtë seancës gjyqësore, më datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia me numër C.nr.2231/2023, e datës 23.06.2023, e paditësit E.B. nga Prizreni, kundër të paditurës H.S. me objekt kontesti vërtetim i pronësisë.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi E.B. nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. B.Gj. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me dt.23.06.2023 ka parashtruar padinë, kundër të paditurës H.S. me objekt të kontestit vërtetim i pronësisë.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, pala paditëse përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate me dt. 29.04.2024, ka dorëzuar parashtrësën për tërheqje nga padia dhe kërkesëpafia, me ç ‘rast ka theksuar se palët ndërgjyqëse në mes vete kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore dhe atë në procedurë të ndërmjetësimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit për këtë çështje të konsiderohet e tërhequr.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të konstatohet e tërhequr padia e paditësit, në përputhje me nenin 261 të LPK-së. Kështu, në nenin 261 par. 1 të LPK-së theksohet që *“Paditësi mund ta tërheq padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*.

Numri i lëndës: 2023:141241

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05645460

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e saj procedurale.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 261 dhe 387 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.2231/2023 të datës 02.05.2024

Gj y q t a r j a

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 261 par. 4 të LPK-së.